



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT
SEKRETARIA / SEKRETARIJAT / SECRETARIAT

Prishtinë, më 25 tetor 2017

**Fjalimi i Kryetares së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës,
znj. Arta Rama-Hajrizi**

Jam thellësisht e nderuar dhe kam kënaqësinë të hap ceremoninë solemne të këtij viti të ri gjyqësor, në emër të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Fillimisht, dëshiroj të përshëndes dhe të falënderoj për pjesëmarrjen e tyre në shënimin e përvjetorit të 8-të të Gjykatës sonë përfaqësuesit më të lartë të institucioneve të Republikës së Kosovës, përfaqësuesit ndërkombëtarë dhe diplomatët e akredituar në vend, e në veçanti dua të përshëndes delegacionet nga rajoni, që na kanë nderuar me praninë e tyre në këtë ceremoni: delegacionin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, delegacionin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë, delegacionet e gjykatave kushtetuese të Turqisë, të Bullgarisë, të Maqedonisë, të Malit të Zi, si dhe të Kroacisë, gjyqtarët e gjykatave të rregullta dhe prokurorët e Republikës së Kosovës dhe të tjerët të pranishëm.

Pjesëmarrja juaj në këtë ceremoni e shton edhe më shumë rëndësinë që ka për ne ky përvjetor, duke na obliguar njëherësh që të kultivojmë edhe më tej raportet e miqësisë, të bashkëpunimit dhe të respektit të ndërsjellë.

Kosova, si shtet i ri, ballafaqohet me procese të shumta sfiduese dhe është në përpjekje të vazhdueshme për konsolidimin dhe për avancimin e demokracisë, për forcimin e sundimit të ligjit, për zhvillimin ekonomik dhe me përkushtim ndaj proceseve integruese. Këto sfida nuk janë vetëm të karakterit politik, por edhe ekonomik, social e ligjor. Gjithsesi, e njëjta gjendje sfiduese, reflektohet edhe në punën dhe në praktikën e përditshme të Gjykatës Kushtetuese, e cila që nga themelimi, nëpërmjet vendimeve të saj, ka qenë pjesë e këtyre proceseve dhe ka ndikuar në përpjekjet për tejkalimin e tyre.

Gjykata Kushtetuese, gjithmonë në përputhje me mandatin dhe me kompetencat e përcaktuara me Kushtetutën e Kosovës dhe me aktet e tjera juridike, po vazhdon të krijojë praktikën e saj ligjore, e cila në disa prej fushave të gjykimit kushtetues tashmë mund të quhet lirisht praktikë e konsoliduar gjyqësore. Vlen të përmenden

rastet e ashtuquajtura individuale, që ndërlidhen me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore, të garantuara me Kushtetutë dhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe më tej të zhvilluara dhe të interpretuara nga praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane.

Ndërtimi dhe zhvillimi i kësaj praktike gjyqësore është i një rëndësie të shumëfishtë. Para së gjithash, ajo është bërë një ndihmesë me rëndësi për parashtruesit e kërkesave dhe për përfaqësuesit e tyre, duke ndikuar drejtpërdrejt në përpilimin më profesional dhe më kualitativ të parashtrësive.

Për më tepër, kjo kontribuon në mënyrë të jashtëzakonshme në përf forcimin e parimit të sigurisë juridike dhe të një sistemi adekuat dhe stabil të mbrojtës së të drejtave dhe lirive themelore të qytetarëve të Republikës tonë, që rezulton në jetësimin e Kushtetutës tonë në praktikë, me të gjitha atributet e saj si akti më i lartë juridik i vendit.

Karakteri detyrues i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese si dhe rëndësia e efekti që kanë jo vetëm te palët, zgjojnë shpesh kërshtërinë e opinionit publik dhe bëhen objekt i diskutimeve dhe i debateve publike. Jo rrallëherë, këto debate dhe vlerësime bëhen mbi baza dhe motive të tjera, por jo mbi ato profesionale.

Ndër tjera, mund të përmend proceset zgjedhore nga të cilat pritej konstituimi i institucioneve nacionale apo lokale, që kanë rezultuar në situata kur edhe Gjykatës Kushtetuese i është kërkuar të interpretojë norma kushtetuese dhe trajtimi i këtyre kërkesave ka ngjallur vëmendje të shtuar te opinionit i gjerë.

Në shtetet demokratike, çështjet politike sado të komplikuar të jenë, zgjidhen dhe duhet të zgjidhen me mjete dhe me instrumente politike, ndërsa çështjet juridike, sado që janë komplekse e të ndërlikuara, zgjidhen me mjete juridike dhe nga institucionet përkatëse. Nuk është mirë dhe nuk është e shëndetshme për demokracinë nëse çështjet dhe problemet politike tentohet gjithëherë të zgjidhen me mjete juridike, sepse si të tilla mund të bëhen pengesë e zhvillimeve demokratike. Për shembull, nuk do të duhej që, në fund të secilit proces elektoral, Gjykata Kushtetuese të shihet si ARBITËR i rezultateve zgjedhore dhe nuk është mirë që Gjykata Kushtetuese të perceptohet si përcaktues i institucioneve të dala nga zgjedhjet. Gjykata nuk do ta bëjë atë rol dhe as nuk e ka atë detyrë. Në këtë drejtim, do të ishte e dëshirueshme që, përpos në rastet kur qartë paraqiten situata të “konfliktit kushtetues”, Gjykata Kushtetuese të mos përfshihet fare. Natyrisht, kjo nuk do të thotë që Gjykata ka hezituar dhe nuk do të hezitojë kurrë të trajtojë secilin rast që i parashtrohet, duke përfshirë dhe rastet që lidhen me proceset elektorale, kur ato janë brenda kompetencave të saj.

Më lejoni që në vazhdim të ndaj me ju disa prej vendimeve më me rëndësi që Gjykata ka marrë gjatë këtij viti gjyqësor, e të cilat zgjuan një interesim të madh të opinionit jo vetëm vendor.

Dy prej këtyre vendimeve pa mëdyshje janë rasti i vlerësimit të kushtetutshmërisë së Ligjit për Trepçën, si dhe i Ligjit për investimet strategjike.

Të dyja këto raste u parashtruan nga një numër deputetësh të Kuvendit të Kosovës që përfaqësojnë komunitetet joshumicë në Kuvend. Në të dyja rastet, ishin kontestuar ligjet edhe në aspektin procedural, duke pretenduar se ligjet në fjalë hyjnë në grupin e ligjeve me “interes vital” edhe në aspekt përmbajtësor, duke pretenduar shkelje të të drejtave pronësore.

Pasi shqyrtoi me kujdes rastet, Gjykata gjeti se objektivi i Ligjit për Trepçën dhe i Ligjit për investime strategjike është përmirësimi i zhvillimit ekonomik, punësimi, zbatimi i teknologjive të reja me qëllim të rritjes së aftësive konkurruese të ndërmarrjes dhe të Kosovës. Gjykata konstatoi se përfitimet e propozuara të Ligjit për investime strategjike nuk janë të kufizuara në një komunitet ose në një komunitet tjetër, por janë me interes të përgjithshëm publik dhe synojnë mirëqenien e tërë shoqërisë dhe rrjedhimisht vendosi që këto dy ligje janë kushtetuese për nga përmbajtja dhe për nga procedura e ndjekur për miratimin e tyre nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Vlen të theksohet se, veçanërisht në rastin e Ligjit për Trepçën, u zhvilluan shumë debate publike, disa prej të cilave madje tejkaluan edhe hapësirën gjeografike të shtetit tonë. Natyrisht, si edhe herëve të tjera, Gjykata Kushtetuese nuk u bë palë polemizuese në këtë situatë, por bazuar në kompetencat kushtetuese dhe në praktikën e vet gjyqësore, si dhe pas hulumtimeve krahasuese, nxori vendimin meritor.

Vetëm një gjykatë kushtetuese e pavarur dhe e paanshme mund të gëzojë besimin e plotë edhe të palëve, e edhe të qytetarëve, në përgjithësi. Në fakt, kjo nuk do të duhej të ishte vetëm karakteristikë e gjykatave kushtetuese, por edhe e të gjitha institucioneve të tjera, që me Kushtetutë janë të përcaktuara si të pavarura.

Përkitazi me këtë çështje, Gjykata Kushtetuese kishte pranuar për shqyrtim rastin e paraqitur nga Institucioni i Avokatit të Popullit, i cili kontestonte kushtetutshmërinë e një akti administrativ të Ministrisë së Administratës Publike (MAP), me të cilin, sipas Avokatit të Popullit, cenohej pavarësia kushtetuese jo vetëm e institucionit të cilin ai përfaqëson, por edhe e institucioneve të tjera të pavarura kushtetuese, përfshirë edhe Gjykatën Kushtetuese.

Gjykata vlerësoi pretendimet e parashtruesit, bëri pyetje për rastet e ngjashme në vendet anëtare të Komisionit të Venecias, konsultoi praktikën e vet të mëhershme

gjyqësore dhe, pasi i bëri një shqyrtim të plotë rastit dhe analizoi edhe përgjigjet e marra nga nëntë shtete anëtare të Komisionit të Venecias, konkludoi se akti administrativ i MAP-it, me përmbajtjen që ka, e cenon pavarësinë kushtetuese të organeve kushtetuese të pavarura, e në veçanti të Gjykatës Kushtetuese dhe të Avokatit të Popullit.

Gjykata, me këtë rast, nuk mohoi kompetencën e Qeverisë që, ndër të tjera, të unifikojë titujt e punës dhe gradat e nëpunësve shtetërorë, por potencoi faktin që çdo iniciativë e tillë që nuk bëhet në konsultim me institucionet përkatëse dhe që nuk merr parasysh specifikat dhe garancitë kushtetuese për pavarësinë e institucioneve të pavarura, do të jetë kundërkushtetuese. Pavarësia e institucioneve të pavarura, siç është garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, nuk mund të pakësohet me asnjë akt tjetër juridik me fuqi juridike me të ultë se vetë Kushtetuta.

Pra, Gjykata konkludoi që pavarësia e institucioneve të pavarura, e garantuar me Kushtetutë, nuk është vetëm funksionale, por edhe organizative e financiare. Në fakt, paanshmëria e tyre varet nga kjo pavarësi.

Para jush shpalosa disa nga vendimet më me rëndësi të vitit të fundit. Tani më lejoni që t'i paraqes edhe disa prej sfidave me të cilat u përballëm ose na presin në të ardhmen jo edhe aq të largët.

Në ceremoninë e vitit të kaluar, duke falënderuar gjyqtarin Carolan, i cili dha dorëheqjeje nga Gjykata, njëkohësisht bëra thirrje që Kuvendi të plotësojë në afat sa më të shkurtër kohor pozitën e lirë që mbeti. Tani ende jemi në pritje të plotësimit të asaj pozite dhe kjo thirrje mbetet aktuale.

Por, në vitin e ardhshëm Gjykatën tonë e pret një sfidë edhe më e madhe për funksionimin e saj, kur edhe pritet të marrë fund mandati i katër gjyqtarëve të tjerë.

Dëshiroj të tërheq vërejtjen se, nëse procesi për zëvendësimin e gjyqtarëve nuk do të zhvillohet brenda afateve të parapara me Kushtetutë, Gjykata Kushtetuese rrezikon të humbë edhe shumicën e domosdoshme për vendimmarrje. E, një gjykatë kushtetuese jofunksionale rrezikon edhe vetë themelet e ekzistencës dhe të sundimit të ligjit në një vend.

Viteve të fundit, ndryshimet në sistemin gjyqësor të Kosovës dhe në përgjithësi në sistemin e drejtësisë në vend, kanë qenë të shumta dhe pozitive. Gjykata Kushtetuese i është nënshtruar një procesi të vazhdueshëm të ngritjes së kapaciteteve profesionale dhe të reformës organizative, kryesisht falë edhe ndihmës së çmuar të partnerëve tanë ndërkombëtarë.

Në këtë aspekt, për mbështetjen e vazhdueshme financiare dhe për ndihmën e pakursyer që i kanë ofruar Gjykatës Kushtetuese përgjatë viteve, dëshiroj posaçërisht të falënderoj kontributin e shtetit gjerman, nëpërmjet GIZ-it, IRZ-së, si dhe Zyrën e Këshillit të Evropës në Kosovë.

Një falënderim i veçantë për njërin nga mbështetësit kryesorë të gjykatës sonë, shtetin amerikan që, nëpërmjet USAID-it, këtë vit ofroi një përkrahje të çmuar në ndryshimin e Rregullores së punës së Gjykatës dhe ridizajnimin e ueb-faqes zyrtare të Gjykatës, që për nga standardi dhe për nga cilësia e kërkimit të vendimeve pritet të jetë ndër ueb-faqet më të avancuara të gjykatave kushtetuese jo vetëm në rajon. Ky investim do të ndikojë patjetër edhe në ngritjen e mëtejme të transparencës së Gjykatës ndaj publikut.

Së fundi, më lejoni të shpreh falënderimin më të sinqertë për të gjithë kolegët e mi, për Zëvendëskryetarin dhe për të gjithë gjyqtarët e tjerë, pa të cilët sukseset e Gjykatës Kushtetuese do të ishin pa dyshim të mangëta.

Për punën e tyre të palodhshme dhe vërtet profesionale, fare në fund, dua të falënderoj edhe Sekretarin e Përgjithshëm, këshilltarët ligjorë, Kabinetin tim, si dhe tërë stafin administrativ të Gjykatës Kushtetuese.